



19-25 JANAR

JAVA E MBROJTJES



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

MINISTRI VENUGU INSPEKTON KOMPLEKSIN STËRVITOR NË BIZË

Ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu inspektoi kompleksin stërvitor në Bizë/Pajet, një investim strategjik që synon modernizimin dhe fuqizimin e kapaciteteve të trajnimit të Forcave të Armatosura si dhe zhvillimin e stërvitjeve ndërkombëtare sipas standardeve bashkëkohore të NATO-s. Gjatë inspektimit, ministri Vengu u njoh nga afër me infrastrukturën dhe kapacitetet funksionale të kompleksit.

★★★★★

mod.gov.al

JM



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

MINISTRI VENUGU PRET HOMOLOGUN BELG

Ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu priti në një takim homologun e tij belg Theo Francken, i cili zhvilloi një vizitë zyrtare në Tiranë. Gjatë takimit, dy ministrat diskutuan mbi forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve dypalëshe në fushën e Mbrojtjes, me fokus të veçantë në stërvitjet e përbashkëta, ritjen e ndërveprimit operacional dhe zhvillimin e bashkëpunimit në industrinë e mbrojtjes. Këto elemente konsiderohen thelbësore për ritjen e kapaciteteve mbrojtëse dhe për forcimin e sigurisë rajonale.

★★★★★

JM



INTERES NË RITJE PËR FORCAT E ARMATOSURA

Në fazën e parë të rekrutimeve për vitin 2026 janë regjistruar 343 aplikime, duke vijuar trendin pozitiv të vitit 2025. Rritja e pagave, shërbimi si karrierë dhe rikthimi i dinjitetit po shtojnë interesin dhe besimin e të rinjve për uniformën dhe shërbimin ndaj atdheut, ndërsa vijon puna për rritjen në sasi dhe cilësi të komponentit aktiv në Forcat e Armatosura.

JM



KUNDËRADMIRAL ARSEN MULLAJ MERR DETYRËN E KOMANDANTIT TË FD

Kundëradmiral Arsen Mullaj mori zyrtarisht detyrën e komandantit të Forcës Detare, pas dekretimit nga presidenti i Republikës. Ai zëvendëson në këtë detyrë nënadmiral Adnand Agastra, i cili përfundon mandatin e tij në krye të Forcës Detare. Në ceremoninë e dorëzimit të detyrës mori pjesë ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, i cili vlerësoi ndërrimin e komandës si pjesë të vazhdimësisë profesionale dhe forcimit të leadershipit në Forcat e Armatosura.

★★★★★

FORCA AJRORE SHQIPTARE STËRVITET ME FORCËN AJRORE AMERIKANE

Në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës, Forca jonë Ajrore u trajnua me Forcën Ajrore të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, duke forcuar më tej aftësitë mes dy vendeve aleate të NATO-s, në gatishmëri për çdo mision. Stërvitja e përbashkët me Forcën Ajrore të Shteteve të Bashkuara u fokusua në forcimin e ndërveprimit, rritjen e gatishmërisë, reagimin e shpejtë në kohë krize, si dhe përvetësimin e procedurave bashkëkohore operacionale me aleatët e NATO-s.

★★★★★

105 VJET BATALIONI I XHENIOS

Në një ceremoni solemne u shënua 105 - Vjetori i Themelimit të Batalionit të Xhenios, një nga armët më të rëndësishme dhe më të specializuara të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu në fjalën e tij në ceremoni vlerësoi kontributin historik dhe aktual të Batalionit të Xhenios në mbështetje të sigurisë kombëtare, zhvillimit të infrastrukturës dhe përballimit të emergjencave civile. ★★★★★

JM

XHENIOT LARGOJNË MUNICIONET NË LEZHË E ELBASAN

Specialistët EOD të Batalionit të Xhenios kanë vijuar operacionet në mbështetje të autoriteteve civile në bashkitë Lezhë dhe Elbasan. Gjatë ndërhyrjeve në njësitë administrative Kolsh dhe Mengël, ata kanë kryer vlerësimin, identifikimin dhe transportimin e municioneve ushtarake të gjetura në terren.

JM

